

Tiranë, 22 Janar 2026

Drejtuar:

Z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë
Kryeministria, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 7, 1010, Tiranë, Shqipëri

Z. Sofjan Jaupaj, Ministër i Mjedisit
Rruga Sheshi Skënderbej 6, Tiranë

Subjekti: Kërkesë për pezullimin e çdo nisme ndërtimi në Ishullin e Sazanit për shkak të rrezikut ndaj llojeve të mbrojtura dhe trashëgimisë natyrore e kulturore të zones

I nderuar Kryeministër Edi Rama,
I nderuar Ministër i Mjedisit Sofjan Jaupaj,

Në emër të 41 organizatave nënshkruese nga 28 vende që përfaqësojnë këtë letër, ju drejtohem për të shprehur shqetësimin tonë të thellë lidhur me zhvillimet e fundit në Ishullin e Sazanit, i vetmi ishull i Shqipërisë. Projekti “Investim Strategjik me Procedurë të Veçantë¹”, i miratuar në janar 2025, parashikon ndërtimin e një resorti luksoz. Zhvillimi i propozuar do të përfshinte ndërhyrje në një sipërfaqe prej 45 hektarësh në Ishullin e Sazanit, duke ngritur shqetësime serioze për ndikimin e tij në mjedis dhe përputhshmërinë me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Ishulli i Sazanit rrethohet nga Parku Kombëtar Detar, i shpallur me Vendim të Këshillit të Ministrave, datë 28 prill 2010, dhe klasifikohet si Park Kombëtar (Kategoria II sipas standardeve të IUCN). Për më tepër, kjo Zonë e Mbrojtur Detare është shpallur Zonë Veçanërisht e Mbrojtur me Rëndësi për Mesdheun (SPAMI)² sipas Protokollit për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura të Konventës së Barcelonës, i cili synon mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve kritike në Detin Mesdhe. Gjithashtu, Ishulli i Sazanit njihet si pjesë e një Zone Kyçe për Biodiversitetin (KBA)³ dhe Zone të Rëndësishme për Shpendët (IBA), brenda zonës KBA/IBA⁴ të Gjirit të Vlorës, Karaburunit dhe Malit të Çikës.⁵

Ujërat përreth Sazanit ofrojnë habitate me vlerë dhe jetike për gjitarin detar më të rrezikuar globalisht, fokën e Mesdheut. Bregdeti rreth Sazanit karakterizohet nga livadhe të gjera nënujore me *Posidonia*, thelbësore për biodiversitetin dhe klimën.

Ndërtimi i një resorti luksoz, me ndërhyrje infrastrukturore në shkallë të gjerë si trafiku detar, rrugët dhe sistemet e kanalizimeve, përbën një kërcënim serioz për këto habitate delikate. Ndërhyrje të tilla sjellin zhurmë, ndriçim artificial, ndotje dhe rritje të pranisë së njeriut, të cilat mund të largojnë jetën e egër nga zonat kritike, përfshirë shpellat bregdetare që janë thelbësore për mbijetesën e fokës së Mesdheut.

Theksojmë se ky projekt dhe mënyra e miratimit të tij bien drejtpërdrejt në kundërshtim me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, veçanërisht në dritën e hapjes së negociatave për Kapitullin 27 (Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike). Qëndrimi i Përbashkët i BE-së për

1 https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2025/01/VKIS_Resorti_Turistik_Ishulli_i_Sazanit_.pdf

2 https://rac-spa.org/sites/default/files/doc_spamis/liste_aspim_2020.pdf

3 <https://www.keybiodiversityareas.org/site/factsheet/2908>

4 BORGHESI_F,2013_The_breeding_bird_community_of_Sazani_island

5 <https://www.keybiodiversityareas.org/site/factsheet/2908>

Grupin 4 përcakton si kritere mbyllëse për Kapitullin 27 përafrimin e plotë me *acquis* të BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës, biodiversitetit, vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe qeverisjes transparente e gjithëpërfshirëse. Në këtë kontekst, Qëndrimi i Përbashkët përmend në mënyrë specifike nevojën për përafrim me *acquis* të BE-së përmes shfuqizimit të dispozitave të papajtueshme të miratuara me ndryshimet në ligjin për Zonat e Mbrojtura (Ligji nr. 21/2024) dhe përmes përfundimit të legjislacionit të vitit 2015 për investimet strategjike.

Në këtë kuadër, kërkojmë me respekt dhe urgjencë:

1. Pëzullimin e menjëhershëm të çdo vendimi ekzekutiv ose parlamentar që lidhet me avancimin e këtij projekti;
2. Përfshirjen formale të pjesës tokësore të Ishullit të Sazanit brenda Parkut Kombëtar Detar Karaburun–Sazan, të njohur si Zonë Veçanërisht e Mbrojtur me Rëndësi për Mesdheun (SPAMI);
3. Regjistrimin zyrtar të ishullit si Zonë Kandidate Emerald⁶, si pjesë e rrjetit ekologjik të Zonave me Interes të Veçantë për Ruajtje (ASCIs) nën kujdesin e Këshillit të Evropës, dhe si pjesë e ardhshme e rrjetit Natura 2000 të BE-së;
4. Zbatimin e plotë të detyrimeve të Shqipërisë sipas konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, veçanërisht atyre që lidhen⁷ me ruajtjen e fokës së Mesdheut dhe habitateve të saj.

Ju bëjmë thirrje të ndërmerrni veprime të menjëhershme për të parandaluar degradimin e një prej pasurive ekologjike më të rralla të Shqipërisë dhe Mesdheut, në emër të ruajtjes së natyrës, sundimit të ligjit dhe përgjegjësisë ndaj brezave të ardhshëm.

⁶ <https://emerald.eea.europa.eu/>

⁷ Convention on Biological Diversity (CBD 1992)

Barcelona Convention for the Protection of the Marine Environment and the Coastal Region of the Mediterranean (1975, amended in 1995)

Protocol Concerning Specially Protected Areas and Biological Diversity in the Mediterranean (SPA/BD) (1995)

Bern Convention on the Conservation of European Wildlife and Natural Habitats (1979)

Bonn Convention on the Conservation of Migratory Species of Wild Animals (1979)

Nënshkrimet:

No	Institution's Name	E-mail address	Institution's Logo
1	Protection and Preservation of Natural Environment in Albania	contact@ppnea.org	
2	Center for Protection and Research of Birds of Montenegro	czip@czip.me	
3	EcoAlbania	contact@ecoalbania.org	
4	Montenegro Dolphin Research (MDR)	info@dmad.org.tr	
5	Society for the Protection of Prespa	spp@spp.gr	SOCIETY FOR THE PROTECTION OF PRESPA 

6	Center for Environment (Bosnia and Herzegovina)	info@czzs.orr	 Centar za životnu sredinu
7	Resource Environmental Center Albania (REC Albania)	info@recshqiperi.org	
8	NGO Eco-team	office@ecoteam.me	 ECO-TEAM ENVIRONMENTAL PROTECTION
9	NGO Montenegrin Ecologists Society	drustvoekologa@gmail.com	 CRNOGORSKO DRUŠTVO EKOLOGA

10	PIM Initiative	pim@initiative-pim.org	 INTERNATIONAL NGO FOR MEDITERRANEAN SMALL ISLANDS
11	Mediterranean Center for Environmental Monitoring (MedCEM)	medcem@yahoo.com	Mediterranean Center for Environmental Monitoring  Mediterranski Centar za Ekološki Monitoring
12	Tour du Valat	secretariat@tourduvalat.org	 Tour du Valat A research institut for the conservation of Mediterranean wetlands
13	Green Home	greenhome@greenhome.co.me	 GREEN HOME act green

14	SPOT Marine Life	info@cyprusturtles.org	
15	Society for the Protection of Nature in Lebanon	news@spnl.org	
16	Mediterranean Association to Save the Sea Turtles - MEDASSET	medasset@medasset.org	
17	Archipelagos - environment and development	archipelagos.greece@gmail.com	

18	MOM / Hellenic Society for the Study & Protection of the Monk Seal	info@mom.gr	
19	The Octopus Foundation	contact@octopusfoundation.org	
20	Archipelagos - ambiente e sviluppo, Italia	archipelagos.italia@gmail.com	
21	BirdLife Europe and Central Asia	anouk.puymartin@birdlife.org	

22	Delphis NGO, for the conservation of marine mammals, Israel	elasar.ma@gmail.com	
23	Mediterranean Biodiversity Consortium	douchin@tourduvalat.org	
24	Tethys Research Institute	istituto.tethys@gmail.com	

25	BirdLife Sverige	daniel.bengtsson@birdlife.se	 
26	Lipu-BirdLife Italy	claudio.celada@lipu.it	
27	OTOP-BirdLife Polska	jaroslaw.krogulec@otop.org.pl	
28	BirdLife Norway	martin@birdlife.no	

29	Association Biom	lora.rajic@biom.hr	
30	Gibraltar Ornithological & Natural History Society	info@gonhs.org	
31	Latvian Ornithological Society	viesturs@lob.lv	
32	BirdLife Cyprus	birdlifecyprus@birdlifecyprus.org.cy	

33	The Wilderness LLC	a.vintchevski@gmail.com	
34	Doğa Derneği	doga@dogadernegi.org	
35	Bird Protection and Study Society of Serbia	sekretar@pticesrbije.rs	
36	Macedonian Ecological Society	contact@mes.org.mk	

37	Czech Society for Ornithology	verm@birdlife.cz	
38	Monk Seal Alliance	apertuisot@fpa2.org	
39	Prince Albert II of Monaco Foundation	Vila Girasole 16 Boulevard de Suisse Monaco MC 98000 T. +377 98 98 44 44	
40	Foundation Segre	info@fondationsegre.org	
41	EuroNatur	gabriel.schwaderer@euronatur.org	

Shtojca 1

Ana perëndimore e Ishullit të Sazanit karakterizohet nga shkëmbinj të thepisur vertikalë dhe kanione të thella, të cilat përmbajnë shpella detare që përbëjnë habitate kyçe për fokën e Mesdheut (*Monachus monachus*), një nga gjitarët detarë më të rrezikuar në botë. Ky lloj është i përfshirë në Listën e Kuqe të IUCN-së për Speciet e Rrezikuara dhe në Aneksin I dhe II të Konventës për Speciet Migratore (CMS). Ishulli i Sazanit dhe ujërat përreth tij strehojnë të paktën 36 specie detare të rrezikuara globalisht. Shtresat e forta infralitorale dhe substratet shkëmbore përreth ishullit mbështesin livadhe të gjera të *Posidonia oceanica*, një bimë detare thelbësore për shëndetin dhe produktivitetin e ekosistemit të Mesdheut. Falë izolimit të tij afatgjatë, Sazani shërben si një laborator natyror për studimin e evolucionit dhe shpërndarjes së specieve, duke strehuar disa organizma endemikë. Pavarësisht përdorimit të ishullit si zonë ushtarake nga viti 1947 deri në vitin 1992, një pjesë e madhe e tij mbetet e paprekur, duke ruajtur gjurmë të vegjetacionit bregdetar original të Shqipërisë, i cili shtrihet deri në vijën bregdetare.⁸

Që nga viti 2019, të dhëna shkencore mbi praninë dhe shpërndarjen e fokës të Mesdheut janë mbledhur përmes monitorimit sistematik të kryer nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Vlorë, në bashkëpunim me OIQ kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, pjesë e rrjetit Monk Seal Alliance. Aktivitetet e monitorimit kanë përfshirë vëzhgime me kamera-kurth dhe raportime nga vëzhgime lokale. Të gjitha të dhënat e mbledhura konfirmojnë një prani të fortë dhe të qëndrueshme të kësaj speciejë brenda Zonës së Mbrojtur Detare Karaburun–Sazan.

*Kjo tabelë paraqet 36 specie detare të rrezikuara globalisht që gjenden në Parkun Kombëtar Detar Karaburun–Sazan në Shqipëri. Ajo përfshin bimë detare, sfungjerë, molusqe, krustace, peshq, zvarranikë, pinnipedë dhe cetace. Të gjitha këto specie gëzojnë status mbrojtjeje sipas disa konventave ndërkombëtare, si Konventa e Barcelonës, Konventa e Bonit, CITES dhe Konventa e Bernës. Shumë prej tyre, si *Posidonia oceanica*, *Pinna nobilis*, si dhe lloje të ndryshme jovertebrore dhe vertebrore emblematike, përfshirë *Caretta caretta*, *Monachus monachus* dhe *Delphinus delphis*, janë të listuara në Aneksin II të Konventës së Barcelonës.*

Specie name	SPA/ BD Protocol of the Barcelona Convention ¹ (1996)		Bonn ² (2006)		CITES ³ (2006)	Bern ⁴ (1993)
	Ann. II	Ann. III	App. I	App. II		
Magnoliophyta						
<i>Posidonia oceanica</i>	+					+
<i>Cymodocea nodosa</i>						+
Phaeophyta						
<i>Cystoseira amentacea</i> var. <i>spicata</i>	+					+
Rhodophyta						
<i>Lithophyllum byssoides</i>	+					
<i>Lithophyllum torochanter</i>	+					
Spongia						
<i>Geodia cydonium</i>	+					
<i>Hippospongia communis</i>		+				+
<i>Spongia officinalis</i>		+				+
<i>Petrobiona massiliana</i>						+

⁸ MEDAIL F et al, 2014 Terrestrial flora Sazani island light

Cnidaria						
<i>Corallium rubrum</i>		+				+
Mollusca						
<i>Ranella olearia</i>	+					+
<i>Tonna galea</i>	+					+
<i>Charonia tritonis</i>	+					+
<i>Zonaria pyrum</i>	+					+
<i>Pholas dactylus</i>	+					+
<i>Pinna nobilis</i>	+					
<i>Lithophaga lithophaga</i>	+				+	+
Crustacea						
<i>Homarus gammarus</i>		+				+
<i>Maja squinado</i>		+				+
<i>Scyllarides latus</i>		+				+
<i>Scyllarus arctus</i>		+				+
<i>Palinurus elephas</i>		+				+
Echinodermata						
<i>Paracentrotus lividus</i>		+				+
<i>Ophidiaster ophidianus</i>	+					+
<i>Centrostephanus longispinus</i>	+					+
Pisces						
<i>Anguilla anguilla</i>		+				
<i>Umbrina cirrhosa</i>		+				
<i>Thunnus thynnus</i>		+				
<i>Sciaena umbra</i>		+				
<i>Hippocampus guttulatus</i>					+	
<i>Epinephellus marginatus</i>		+				+
<i>Xiphias gladius</i>		+				
Reptilia						
<i>Caretta caretta</i>	+		+	+		+
Pinnipedia						
<i>Monachus monachus</i>	+		+	+	+	+
Cetacea						
<i>Tursiops truncatus</i>	+			+	+	+
<i>Delphinus delphis</i>	+		+	+		+

1 Protocol Concerning Specially Protected Areas and Biological Diversity in the Mediterranean of the Convention for the Protection of the Mediterranean Sea Against Pollution

2 Convention on the Conservation of Migratory Species of Wild Animals

3 Convention on International Trade in Endangered Species of Wild Fauna and Flora


4 Convention on the Conservation of European Wildlife and Natura Habitats

Source: Beqiraj S., Zuna V., Dodbiba E. (2010). *Priority Action Plan for Sazani-Karaburuni Marine Protected Area*. GEF/UNDP. Tirana: 74 pp.

Shtojca II

Harta më poshtë paraqet Parkun Kombëtar Detar Karaburun–Sazan, i shpallur Zonë e Mbrojtur sipas legjislacionit shqiptar në vitin 2010. Fokusi është te Ishulli i Sazanit, i cili rrethohet nga Parku Kombëtar Detar dhe është i ndarë në dy nënzona: Zona Bërthamë (jeshile e errët) dhe Zona e Përdorimit të Qëndrueshëm.

Zona (jeshile e hapur). Kjo hartë është marrë nga geoportal.asig.gov.al



Shtojca III

Listë kontrolli e specieve të raportuara gjatë studimit të kryer në Ishullin e Sazanit në maj 2013.

Referenca taksonomike: AERC. (<http://www.aerc.eu/documents.html>). B=Breeding; M=Migrating; E=Erratic

Source: "The breeding bird community of Sazani island (Albania) : state of knowledge and management recommendations" F. Borghesi (ISPRA) 2013

<i>Taxon</i>	<i>Field mission of May 2013</i>	<i>Phenology</i>
<i>Phalacrocorax aristotelis desmarestii</i>	X	E
<i>Accipiter nisus</i>	X	M ?, B ?
<i>Buteo buteo</i>	X	B
<i>Aquila chrysaetos</i>	X	E
<i>Falco tinnunculus</i>	X	B
<i>Falco subbuteo</i>	X	M ?, B ?
<i>Larus michahellis</i>	X	E
<i>Columba livia</i>	X	B
<i>Streptopelia decaocto</i>	X	B
<i>Streptopelia turtur</i>	X	B
<i>Otus scops</i>	X	B
<i>Bubo bubo</i>	X	B
<i>Caprimulgus europaeus</i>	X	B
<i>Apus apus/pallidus</i>	X	B
<i>Apus melba</i>	X	B
<i>Merops apiaster</i>	X	M
<i>Ptyonoprogne rupestris</i>	X	B
<i>Hirundo rustica</i>	X	M ? B ?
<i>Delichon urbicum</i>	X	B
<i>Cecropis daurica</i>	X	B
<i>Oenanthe hispanica melanoleuca</i>	X	M ? B ?
<i>Monticola solitarius</i>	X	B
<i>Turdus merula</i>	X	B
<i>Iduna pallida</i>	X	B
<i>Sylvia cantillans albistriata</i>	X	B
<i>Sylvia melanocephala</i>	X	B
<i>Sylvia borin</i>	X	M
<i>Parus caeruleus</i>	X	B
<i>Oriolus oriolus</i>	X	M ?, B ?
<i>Lanius isabellinus</i>	X	M
<i>Garrulus glandarius</i>	X	B
<i>Corvus monedula</i>	X	B
<i>Corvus corone cornix</i>	X	B
<i>Corvus corax</i>	X	B
<i>Passer domesticus</i>	X	B
<i>Fringilla coelebs</i>	X	B
<i>Carduelis chloris</i>	X	B
<i>Carduelis carduelis</i>	X	B
<i>Carduelis cannabina</i>	X	B